

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Key4Energy" Sh.p.k

Sot, më datë 08/02/2021,

Znj. Orjeta MEÇE, shtetase shqiptare, i datëlindjes 30.10.1985, lindur në Delvinë, dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal I56030051L dhe numër letërnjoftimi 033245500;

Vendosi të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislativit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërise është **"Key4Energy" Sh.p.k**

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brëndshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "Key4Energy" Sh.p.k, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi si dhe në Statutin vijues.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvilimi i aktiviteti ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "Key4Energy" Sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulen e saj.

NENI 4

Objekti veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Projektimi, analizimi, zhvillim dhe prodhimi i programeve kompjuterike (software) në dhe për të gjitha platformat si dhe Ofrimin e shërbimeve mbi programet kompjuterike (software), ofrimin e sistemeve apo infrastrukturës hardware-ike, ofrimin e hostimit të sistemeve dhe të dhënavë, si dhe programeve kompjuterike (software);
2. Projektimi, analizimi, zhvillimi, implementim, adoptimit dhe përshtatje të programeve kompjuterike, të bazave të të dhënavë, migrim të të dhënavë dhe integrim i sistemeve me qëllim vënien në funksion të plotë të tyre dhe infrastrukturës së TIK;
3. Projektimi, ndërtimi, zhvillimi, operimi i qendrave të të dhënavë, administrimit të tyre, krijim, qëndrave apo bazave të informacionit për grumbullimin, përpunimin apo shpërndarjen e sistemeve të informacionit;
4. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
5. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinvueshme. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinvueshme nga dielli, era, uji, etj;
6. Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impianteve fotovoltaikë e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
7. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinvueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike;
8. Mirëmbajtja e centraleve energjitike. Asistenca tekniqe, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import- eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
9. Zhvillim i aktivitet tē tregtisë me shumicë dhe pakicë, aktiviteti i importit-eksportit si dhe prodhimit të të gjithë mallrave, produkteve, licencave apo shërbimeve në fushën e TIK dhe energjisë nga burime të rinvueshme, aparaturave të cdo lloji, sisteme sigurie, monitorimi, vëzhgime dhe kontrolli, materiale të tjera të lidhura me to si dhe të gjithë mallrave apo produkteve në lidhje me implementimin, montimin, instalimin, parametrizimin dhe konfigurimin e tyre;
10. Pjesëmarrje apo ndërmjetësim të investime, kreditimit apo huamarrjes sipas kushteve apo interesave të ndryshme, përfaqësimërfaqësim lidhje e nënkontratave me subjekte të tjera, vendase ose të huaja, kryerjen e veprimeve si agjent doganor për nevoja të kompanisë dhe/apo palëve të tjera;
11. Shoqëria mund të kryeje çdo operacion finansiar tregtar, shërbimi, industrial, me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, që mund të lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një nga objektet apo aktivitetet e sipërmendura;
12. Shoqëria mund të kryeje edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor dhe aktivitetit të saj në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe mund të zhvillojë aktivitet në fushën e ndërtimeve, duke mbulluar të gjithë llojet e punimeve si elektrike, hidraulike, hekuri, aspirimi, kondicionimi, apo të tjera që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një nga objektet apo aktivitetet e sipërmendura;



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në: Rruga "Peti", Pallati Vath Brari, Shkalla 2, kati 3, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri;

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filuar nga dita e regjistrimit është saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali shoqërisë është në vlerën 100,000 njëqind mijë lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare "Key4Energy" Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Znj. Orjeta MECE zotëruese i 1 (një) kuotë me vlerë 100,000 lekë (njëqind mijë lekë) të kapitalit të Shoqërisë;

Kapitali themeltar është shlyèr plotësisht në para nga Ortakët me themelin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:


Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori


Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë do të jetë **Znj. Valbona MECE**. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 9

Të tjera

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filaleve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statuti.



NENI 10

Ruajta e sekretit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë pér dëmet që i janë shkaktuar pér faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet pér themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 12

Nënshkrimi

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejte.

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Key4Energy” Sh.p.k**

Znj. Orjeta MEÇE

Orjeta Mece

AM